

VENDIM
Nr.21, datë 13.1.1997

PËR SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.182, DATË 25.4.1995
“PËR ÇMIMIN E SHITJES SË BARNAVE” DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.311, DATË 6.5.1996 “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT
TË ÇMIMIT TË BARNAVE”

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.182, datë 25.4.1995 “Për çmimet e shitjes së barnave”, shtohet:

“Gjithashtu Ministri i Shëndetësisë dhe i Ambientit miraton intervalet e marzheve të çmimeve të shitjes me shumicë e pakicë të barnave në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, sipas propozimit të Komisionit të çmimit të barnave”.

Pas pikës 7 shtohet pika 7.1 me këtë përmbajtje:

“Bazat grosiste të barnave të vënë në dispozicion të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe degëve të tij në rrethe informacion për çmimin e blerjes e të shitjes së barnave dhe sasinë e tyre. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor përcakton afatin e dërgimit të këtij informacioni dhe e kontrollon atë”.

2. Në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.311, datë 6.5.1996, fjalët “Këshillit të Ministrave” të zëvendësohen me fjalët “Ministrit të Shëndetësisë dhe Ambientit”. Po në këtë pikë shtohet një paragraf si vijon: “Kriteret për përcaktimin e çmimeve referencë hartohen nga Komisioni i çmimeve të barnave dhe miratohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi